

## **N J O F T I M**

### **për përgatitjen e aktit për shpalljen e një pjese të malit Vodno si zonë e mbrojtur në kategorinë e zonës së mbrojtur**

**1. Emri i Ministrisë:** Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor (MMJPH)

#### **2. Problemi:**

Bazuar në të dhënat nga Studimi i valorizimit për zonën e propozuar për mbrojtje "Vodno" në kategorinë e zonës së mbrojtur, dhe duke marrë parasysh vlerat gjeologjike, gjeomorfologjike dhe biologjike, si dhe rëndësinë e veçantë për banorët e Qytetit të Shkupit, u konkludua se Mali Vodno i plotëson kriteret për t'u shpallur zonë e mbrojtur e kategorisë V - zonë e mbrojtur.

Për atë qëllim, MMJPH paraqiti një iniciativë dhe Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut më 17 nëntor 2020 shqyrtoi dhe miratoi Informacionin dhe mori Vendim mbi pranueshmërinë e propozimit për shpalljen e një pjese të Vodnos si zonë të mbrojtur në kategorinë V - Zonë e Mbrojtur dhe e obligoi MMJPH-në që të zhvillojë një debat publik mbi propozimin, të përgatis aktin përfundimtar për shpalljen e një pjese të Vodnos si zonë të mbrojtur në kategorinë V - Zonë e mbrojtur dhe propozimin përfundimtar t'ia dorëzojë Qeverisë për miratim.

**3. Qëllimi:** Shpallja e një pjese të Vodnos si zonë e mbrojtur në kategorinë e zonës së mbrojtur do të mundësojë: mbrojtjen, ruajtjen dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të vlerave natyrore, emërimin e një subjekti administrues që do të kujdeset për zonën e mbrojtur, si dhe miratimin e një plani menaxhimi në përputhje me dispozitat e Ligji për Mbrojtjen e natyrës. Në të njëjtën kohë, sipërfaqja e zonave të mbrojtura do të rritet në nivelin kombëtar dhe kështu do të bëhet përparim në përmbushjen e detyrimeve të Planit Hapësinor të shtetit (2004), qëllimet Aichi të Konventës për Biodiversitetin (CBD), qëllimet dhe veprimet e Strategjisë Kombëtare për Mbrojtjen e natyrës me një Plan Veprimi (2017-2027), Strategjia Kombëtare për Biodiversitetin me një Plan Veprimi për periudhën (2018-2023), si dhe përparim në zbatimin e direktivave të BE-së për habitatet dhe zogjtë, konventat ndërkombëtare, të cilat janë ratifikuar nga shteti ynë (CBD, Bern, CITES, Bon, Ramsar).

#### **4. Korniza kohore për përgatitjen e aktit.**

Nëntor 2020 - Vendim mbi pranueshmërinë e propozimit për shpalljen e një pjese të malit Vodno si zonë e mbrojtur në kategorinë V - Zonë e Mbrojtur (Nr. 44-4543 / 1 i 17 Nëntorit 2020);

- Dhjetor 2020 - përgatitja e Projekt Vendimit për shpalljen e një pjese të Vodno-s si zonë e mbrojtur;
- Janar 2021 - Publikimi i Projekt versionit të parë të vendimit dhe konsultimit me palët e interesuara dhe publikun;
- Shkurt 2021 - organizimi i takimeve, debat publik, shqyrtimi i vërejtjeve të paraqitura nga MMJPH dhe grupet e punës dhe futja e vërejtjeve të paraqitura;
- Mars 2021 - Publikimi i Projekt versionit të dytë të tekstit dhe dorëzimi në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut për konsultim ndërministror dhe miratim.

## 5. Palët e interesuara:

### 1. Organet e administratës shtetërore:

- Ministria e Ekonomisë;
- Ministria e Financave;
- Ministria e Shoqërisë së Informacionit dhe Administratës;
- Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave;
- Ministria e Transportit dhe Lidhjeve;
- Ministria e Kulturës; Zyra për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore;
- Ministria e Mbrojtjes;
- Ministria e Vetëqeverisjes Lokale;
- Sekretariati për Legjislacionin;
- Sekretariati për Çështjet Evropiane;
- Agjencia e Planifikimit Hapësinor;
- IK Qendra Konservuese - Shkup;
- Drejtoria për Punë Hidrometeorologjike;
- Agjencia për Kadastër të Patundshmërive të Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- Agjencia për Promovimin dhe Mbështetjen e Turizmit në Maqedoni.

### 2. Njësitë e vetëqeverisjes lokale

- BNJVL (Bashkësia e Njërive të Vetëqeverisjes Lokale)
- Qyteti i Shkupit,
- Komuna e Karposhit
- Komuna e Sarajit
- Komuna e Qendrës
- Komuna e Kisella Vodës
- Komuna e Sopishtës
- Qendra për Zhvillimin e Rajonit Planifikues të Shkupit.

### 3. Ndërmarrjet dhe institucionet publike:

- NP Pyjet Kombëtare
- NP Parqet dhe Gjellbërimi, Shkup
- Burimet Kombëtare të Energjisë (BKE) Shkup
- Agjencia e Komunikimeve Elektronike (AKE)
- EVN Makededonia Elektranat SHPK Shkup
- SHA MEPSO - Operatori i Sistemit të Transmetimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Shoqëria Aksionare për Transmetimin e Energjisë Elektrike dhe Menaxhimin e Sistemit Energjetik
- Federata e Sporteve Alpinistike të Maqedonisë
- ASHAM (MANU)
- Fakulteti i Shkencave Matematiko - Natyrore,
- Instituti i Biologjisë
- Instituti i Gjeografisë
- Fakulteti i Pylltarisë, Arkitekturës së Peizazhit dhe Ekoinxhinierisë "Hans Em", Shkup
- Fakulteti i Shkencave Bujqësore dhe Ushqimit

- Muzeu i Shkencave Natyrore të Maqedonisë
  - Fakulteti i Ndërtimitarisë, Shkup
  - Universiteti Nënë Tereza, Shkup.
4. Odat Ekonomike
  5. Organizatat joqeveritare që veprojnë në fushën e mbrojtjes së mjedisit jetësor

**6. Mënyra e përfshirjes së publikut të interesuar:**

- Publikimi i projektaktit për komentimin në faqen e internetit të MMPH dhe ENER,
- Debat publik mbi projek-taktin ndërmjet 1 dhe 5 shkurt 2021 (me njoftim dhe ftesë shtesë në media dhe në faqen e internetit të MMJPH-së).
- Kërkimi i mendimeve dhe takime me institucionet qeveritare, njësitë e vetëqeverisjes lokale dhe komunitetin e biznesit.

**7. Adresa e postës elektronike ku palët e interesuara do të jenë në gjendje të shkarkojnë versionin elektronik të ndryshimeve të propozuara në ligj dhe draft Raportin e KPH (ПБР):**

[www.ener.gov.mk](http://www.ener.gov.mk)  
[www.moepp.gov.mk](http://www.moepp.gov.mk)

**8. Adresa dhe / ose adresa e postës elektronike ku mund të paraqiten mendimet, vërejtjet dhe sugjerimet:**

[infoeko@moepp.gov.mk](mailto:infoeko@moepp.gov.mk)

**9. Personi përgjegjës për kontakt në ministri:**

Vlatko Trpeski, Shef i Sektorit për Natyrën  
E-mail: [v.trpeski@moepp.gov.mk](mailto:v.trpeski@moepp.gov.mk)

Vesna Indova, Shefe e Sektorit të BE-së  
E-mail: [v.indova@moepp.gov.mk](mailto:v.indova@moepp.gov.mk)